



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2012/2013

TESTI 1

GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testin të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për zgjidhjen e tyre janë paraparë 120 minuta.
- Lexo me kujdes çdo detyrë, në fillim dhe mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Gjej mënyrën e zgjidhjes së saj (duke rrethuar, lidhur, nënvizuara, përshkruar etj.).
- Në detyrat, në të cilat nga ti kërkohet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejuara (psh. Duhet të shkruhet emër e jo em., kallëzore e jo kall. apo diçka ngjashëm).
- Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Para se të dorëzosh testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaji me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.
- Në katrorin, i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës, mos shkruaj asgjë. Kjo është hapsira ku kontrolluesi shkruan numrin e poenëve. Në këtë hapsirë dhe në faqen e fundit gjithashtu mos shkruaj asgjë.
- Nëse zgjidhjen e detyrave e mbaron më herët, dorëzo testin dhe ngadalë largohu pa i penguar të tjerët.

Të dëshirojmë sukses në provim!

- 1.** Diellza dhe Genti janë motër e vëlla. Ata jetojnë në Preshevë në një apartament në qendër të qytetit. Dëshira e tyre më e madhe është të kenë një qen me të cilin të kalojnë ditën.

Një ditë ata ua shprehën prindërve dëshirën e tyre. Mami dhe babi i dëgjuan me vëmendje. Në fund ata u thanë se s'mund t'ua plotësonin këtë dëshirë. Qenushi kërkonte kujdes. Shtëpia e tyre ishte shumë e vogël dhe gjatë ditës aty nuk kishte njeri. Donte edhe kohë për t'i përgatitur ushqimin, për ta larë, për ta shëtitur etj.

Genti u mërzit shumë. Papritur iu kujtua diçka. Mori albumin e fotove dhe menjëherë shkoi pranë mamit. Në një foto kishte dalë mami e vogël me një qen me emrin Muro. Mami i kishte treguar histori shumë të bukura për qenin e saj. Ai i mbante mend të gjitha dhe kënaqej sa herë i dëgjonte.

- Mami, unë dhe Diellza duam që ju ta mendoni dhe një herë dëshirën tonë. Pas disa ditësh Diellza dhe Genti mbetën të habitur kur panë mamin dhe babin me një qen të vogël në dorë.

- Tani kujdesuni dhe kënaquni me qenin tuaj, ashtu sikur jam gëzuar unë kur kam qenë e vogël, - iu tha mami.

Sa shumë u gëzuan fëmijët!

Dëshira më e madhe e fëmijëve ishte:

- a) të shkonin me pushime.
- b) të kishin një mace.
- c) të kishin një qen.
- ç) të bënin fotografi.

Qarko përgjigjen e saktë.

- 2.** Bie çmimi i mallrave me shumice

Shtetet e Bashkuara thonë se çmimi i mallrave me shumicë ra muajin e kaluar, shenjë kjo që tregon se inflacioni mbetet i ulët. Çmimi që fabrikat paguajnë për mallra dhe material para se ato të arrijnë te konsumatorët ra me 0.1 % në dhjetor. Ekonomistët kishin pritur një rritje për 0.2 % duke përjashtuar kategoritë e ushqimit dhe të energjisë. Ky indeks kryesor që vëzhgohet nga afër u rrit me 0.3. % gjë që është rritja më e madhe nga muaji korrik.

Lexo tekstin a lartshënuar dhe trego se çfarë teksti është:

- 1.
 - a) tekst shkencor
 - b) tekst informativ
 - c) tekst letrar
- 2.
 - a) Informon për zbritjen e çmimeve 0,1%;
 - b) Çmimet ishin ngritur 0,5%)
 - c) Inflacioni kishte rënë për 0,1%

- 3.** Lexo fjalitë e dhëna dhe duke qarkuar përgjigjen e saktë, trego cila prej tyre është shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Qarko përgjigjen e saktë.

- a) Një baba dhe djali i tij përballuan një sundimtar të keq.
- b) Një sundatar i keq mburr Telin për zotsinë e tij.
- c) Një bab dhe çuni i tij provojnë zotsinë e tyre.
- d) Asim Vokshi kryen shumë akte heroike në Spanjë


4. Mirupafshim pushime!

Pushimet mbaruan... uji i liqenit të Pogradecit tashmë është ftohur. Dielli nuk djeg më dhe dita ka filluar të shkurtohet. Sot është mëngjesi i kthimit. Rrezet e diellit hyjnë fshehurazi në dhomën e fëmijëve. Duket sikur duan t' i përshëndesin. Pastaj Drini, Ela e Andi zbresin poshtë. Përqafohen me gjyshërit dhe ulen në ndenjësën e prapme të makinës. Bagazhi i saj mbushet plot. Edhe babai e mamaja hipin në makinë.

- Mirupafshim, mirupafshim!... – thërrasin fëmijët.
- Udhëtim të mbarë, ejani përsëri! Në zërin e gjyshërve ndihet trishtim.

Lexo tekstin e dhënë, nënvizo fjalët kyç dhe shkruaji ato në vizat e dhëna.

5. Shiko tabelën e dhënë dhe rretho katrorët ku flitet për paragrafin dhe si krijohet ai.



6. Lexo letrën dhe gjej cili është: Dërguesi, mesazhi dhe marrësi?

I dashur Ilir, mbaje veten! Je gati?

Po ta shkruaj këtë mesazh me kompjuterin tim të ri! Është e vërtetë! Ende nuk më besohet!

Mamaja erdhi dje në shtëpi dhe më kërkoi ta ndihmoja të ngrinte bagazhet. Kundërshtova pak, por natyrisht shkova dhe e ndihmova. Kur ç` të shoh, një kompjuter fringo i ri brenda në një kuti. Është fantastik! Përse nuk vjen ta shohësh? Do të ishte shumë bukur të takoheshim. Si thua?

Të përqafoj fort!

Emi.

Dërguesi: _____

Mesazhi: _____

Dërguesi: _____

7. Gjej gabimet në fjalitë e mëposhtme. Shkruaj në vizën përbri fjalisë fjalën e saktë.

1. Futbollistat stërviten shumë. _____

2. Shitorja ishte plot mallëra. _____

3. Sa më pëlqen të lundroj në detërat. _____

8. Shkruaj me fjale keta numra

a) 8 _____

b) 13 _____

c) XXII _____

ç) 87 _____

9. Lexo fjalët e dhëna dhe trego cilit dialekt i përkasin

1. ndryshimet fonetike

a) kanë shkue (ue); kanë lanë (a) _____

b) kam mbuluar (ua); lënë (ë) _____

dhe

2. Ndryshimet leksikore.

a) Gjalp; turpëron; gjiton; vjedhës. _____

b) t'lyn; korit; komshi; hajn. _____

10. Preshevë, më 25.12.2012

I dashur ditar,

U habita, mbeta pa fjalë, u çudita jashtëzakonisht shumë! Tani po të tregoj gjithçka. Siç thashë edhe dje, shkova në shkollë pa u përgatitur. Në gjysmën e orës së parë, mësuesja duke na u drejtuar, tha: "Tani të dëgjojmë poezinë."

Menjëherë fillova të përsërisja formulën magjike. Ndërsa po e përsërisja për të tretën herë, mësuesja tha: "Hajde Alisa, se duhet të jesh përgatitur shumë mirë. Nga lëvizja e buzëve vura re që po recitoje me vete poezinë."

I dashur ditar, magji e çfarë magjie!

U çova në këmbë dhe pëshpërita: "nuk e kam mësuar poezinë."

"Po çfarë po pëshpërisje me vete?" – më pyeti mësuesja.

A mund të thosha që isha aq e çuditur sa të besoja te magjia?

Të gjithë do të qeshnin me mua!

Ula kokën dhe fillova të qaja.

Pas pak çastesh heshtjeje, mësuesja m'`u afrua e më tha ëmbëlsisht: "Nëse s'`ke mësuar, do të kesh pasur ndonjë arsye. Mund të ma thoshe në fillim të orës... Sot nuk po të vë notë negative, sepse është hera e parë që vjen pa përgatitur."

"Faleminderit! – iu përgjigja, - Nesër do ta recitoj bukur poezinë."

I dashur ditar, për fat ti je sekret. Tani që të tregova aventurën time, po shkoj me vrap të mësoj.

Mirupafshim!

Lexo tekstin e dhënë dhe trego cilit lloj të teksteve i takon? Rretho përgjigjen e saktë.

a) Ditarit

b) Lajmit

c) Kronikës

d) Referatit.

11. Vendosni shenjën X te fjalët e pandryshueshme.

kështu _____ i ftohtë _____
 moment _____ mbi _____
 sepse _____ larg _____

12. Nga fjalët e mëposhtme ndani fonemat zanore dhe fonemat bashkëtingëllore.

a) Fonemat zanore te fjalët: arë, erë, orë, syri

b) Fonemat bashkëtingëllore: bëj, copë, derë, rrotë, xham,.

13. Fjalitë e mëposhtme janë fjali:

a) Rregulloje radion! _____

b) A e rregulloi radion radiotekniku? _____

c) Radiotekniku e rregulloi orën. _____

d) Mos e rregullo orën. _____

në vizat e dhëna shkruaj çfarë lloj fjalish janë këto?

14. Në grupin e fjalëve të mëposhtme gjeni një emër të përgjithshëm dhe një emër abstrakt.

Lexoj, derë, mirë, nëpër, larg, herët, vonë, habi.

a) emër i përgjithshëm _____

b) emër abstrakt: _____

15. Qarkoni rasën në të cilën është emri i nënvizuar në fjalinë e dhënë.

Turma **njerëzish** nga kryeqyteti kalonin përmes këtij fshati të vogël

a) Emërore

b) Dhanore

c) Kallëzore

d) Rrjedhore

16. Lidh me vijë titujt e veprave me autorët e tyre. Një titull është i tepërt.

Migjeni ----- *Lulet e verës*
 Naim Frashëri ----- *Krushqit janë të ngrirë*
 Petro Marko ----- *Trimi i mirë me shokë shumë*
 Ismail Kadare ----- *Poema e mjerimit*
 Mexhid Mehmeti ----- *Shpella e piratëve*
 Sulejman Pitarka ---- *Monstrumiada*
 ---- *Kujtime të thinjura*

17. “M’ke lype motren para se mejdanin,

M’ke lype berret para se cobanin,
 E jam derdhe n’ket log per me t’kallzue,
 Se ne t’paret nje kanun na kane lane:
 Armet me dhane perpara e mandej gjane;
 Kur bajlozit motren me i’a dhane
 Per me u pre n’at fushen e mejdanit,”

Lexoni me vëmendje vargjet e kësaj kënge dhe thoni:

1. Cilës gjini i takon? _____
2. Cili është personazhi kryesor? _____

18. Kënga “Arnaut Osmani” e marrë nga cikli i këngëve të Mujit dhe Halilit i takon:

- a) Këngëve epike heroike;
- b) Përrallave;
- c) Poezisë lirike

19. Teksti në të cilin autori përveçse sjell fakte dhe dokumente konkrete bën edhe përshkrime tërheqëse, me anën e të cilave e njeh lexuesin me vende e zakone të ndryshme është:

- a) Tekst i biografik;
- b) Tekst autobiografik;
- c) Tekst ditar;
- d) Tekst Udhëpërshkrim

20. Mbramja

Si tufa mëndafshi t'artë në të kaltërten shami,
n'mes dy duersh t'bardha, dy kodra në borë-
flakron përëndimi...Retë mbi krye prorë
ngasin nëpër qiell dhe zhduken n'hapsi.

...Dhe drita e mbrame shuhet mbi çdo sukë:
cipa e natës shtrihet mbi fushat e përhime,
malet heshtin nërrësi si me qenë të ngrime,
si të humbet jeta-xho gja u nxi, u zhduk.

N'ajri ndihen klithmat e natës që ra-
drujt pran rrugës era i përkund...
Ndërsa drita e bardh, e tretun dikund,
shigjeta të flakta mpreh errësinës me i ra.
Terri sundon botën. Katundet e shtrime
në mes të natës prehen n'lugin me andrrime.

Lexo poezinë e dhënë dhe gjej figurat stilistike, metaforën dhe krahasimin, duke i nënvizuar dhe shkruar ato në vizat përkatëse.

1. Metaforën _____

2. Krahasimin _____



Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E paplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✗ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	